

L e n d a: Mbledhja e Komisionit Kombëtar të Nomenklaturave

KKN

Minutat e takimit

Datë 10.05.2019

Më datë 10 maj u mbajt takimi i parë për vitin 2019 i Komisionit Kombëtar për Nomenklaturat. Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT, Znj. Delina Ibrahimaj, njëkohësisht edhe Kryetar i Komisionit të Nomenklaturave përshëndeti anëtarët dhe bëri një prezantim të rendit të ditës, dhe u miratua nga të gjithë pjesëmarrësit.

Në mbledhjen e radhës së KKN-së u diskutua:

1. Situata aktuale e zbatimit të planit të aktiviteteve për vitin 2019.

Përfaqësuesja e INSTAT Znj. Elsa Dhuli, bëri një prezantim të planit të aktiviteteve dhe detyrave të realizuara nga KKN dhe sekretariati. Një nga këto detyra është edhe përgatitja e listës për përkthime. Znj. Dhuli shtoi që Ministria e Shëndetësisë ka kërkuar përkthimin e dy nomenklaturave të cilat nuk janë mbështetur në Acqui, e si rrjedhojë nuk mund të bëhet kërkesë për përkthim në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, e cila mund t'i kërkohej OBSH-së, megjëse kjo organizatë ka mundësuar dhe përkthimin e klasifikimit ICD 10, ose të mendohet mundësia e përkthimit të këtyre klasifikimeve me fonde të tjera. Për këtë vit, është kërkuar përkthimi i dy nomenklaturave, CPA dhe PRODCOM. Përgatitja e listës së klasifikimeve të reja për shqyrtime dhe rishikime për vitin 2019 sipas nevojave të anëtarëve është perfunduar.

Këtë vit u miratuan tre klasifikimeve nga Këshilli i Ministrave, më datë 20.03.2019. Për zbatimin e tyre në mbështetje të VKM do të organizohen trajnime me institucionet përkatëse. Grupet e punës për këtë qëllim do të përgatisin modulet e trajnimit, do të organizojnë trajnimet dhe do të përgatisin raportin final mbi ecurinë e procesit të trajnimeve për KKN.

Nomenklatura GEONOM që i përket një Acqui të rëndësishme, është kërkuar për t'u zbatuar nga Komisioni Evropian. INSTAT ka përkthyer pjesën e përgjithshme që i referohet Acqui-së ndërsa për notën shpjeguese diskutimi do të vazhdojë me Ministrinë për Evropën dhe Punët e

Jashtme. Kjo nomenklaturë si të gjitha nomenklatuat e tjera do të ndjekë të njëjtën procedurë deri në miratimin e saj në Këshillin e Ministrave.

2. Prezantimi i planit të trajnimeve për zbatimin e klasifikimeve të miratuara në datë 20.03.2019

- Përfaqësuesja e Ministrisë së Transportit Znj. Nexhmije Çeka bëri një prezantim të Nomenklaturës së Statistikave të Transportit, NST-2007. Znj. Çeka sqaroi përfitimet dhe lehtësirat që sjell zbatimi i kësaj nomenklature. Ky klasifikim krijon mundësinë e unifikimit të informacionit statistikor duke sjell disa përfitime si: analizën krahasuese të serive kohore të të dhënave midis sektorëve të transportit; hartimin dhe përmisimin e strategjive sektoriale nga politikbërësit e transportit e gjithashtu është më i lehtë dhe i kuptueshëm nga statisticienët si dhe për transmetimin e të dhënave të transportit në EUROSTAT. Ky klasifikim grupon llojet e mallrave në 20 grupe sektoriale kryesore, duke përfshirë kodet e ndarjeve dhe emërtimet përkatëse. Institucionet zbatuese të NST 2007 janë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, institucionet në varësi si Hekurudha shqiptare dhe Portet Detare dhe INSTAT, i cili grumbullon dhe prodhon statistika mbi bazën e të dhënave administrative të siguruar nga burimet më lartë. Znj. Çeka theksoi që brenda muajit maj 2019 do të kryhet trajnimi i punonjësve që mbulojnë statistikat e transportit. Është e domosdoshme që ky trajnim të kryhet brenda muajit maj, pra brenda 6 mujorit të parë të këtij viti në mënyrë që gjatë qershorit, specialistet e trajnuar të përshtasin regjistrat e tyre me klasifikimin e ri NST 2007 dhe në muajin korrik, periudhë që përkon me mbledhjen e statistikave për 6 mujorin e parë, të grumbullohen nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe të dërgohen në INSTAT me klasifikimin NST 2007.
- Nomenklatura e klasifikimit të llojeve të sëmundjeve, ICD-10 u prezantua nga Znj. Majlinda Nesturi, Drejtor në Drejtorinë e Statistikave Sociale në INSTAT, e cila theksoi rëndësinë, përdorimin dhe qëllimin e këtij klasifikimi. ICD-10 është e disponueshme në version të shtypur në tre vëllime, në CD dhe në internet. Në versionin e saj të printuar përbëhet nga tre vëllime që tashmë janë në duart e përdoruesve. Aktualisht, INSTAT përdor klasifikimin ICD 9 për kodifikimin e shkakut të vdekjes sipas grupeve kryesore që ky klasifikim përmban. Për të mundësuar implementimin e klasifikimit ICD, 10 si dhe për të patur një shkallë përputhshmërie të plotë ndërmjet prodhimit të këtyre treguesve propozohet që pasi të kryhet trajnimi i mjekëve të cilët plotësojnë skedën e vdekjes të organizohet një trajnim për zyrat e Gjendjes civile të cilat bëjnë plotësimin e shkakut të vdekjes në aktet e vdekjes që më pas dërgohen në INSTAT.
- Drejtori i Statistikave Ekonomike të INSTAT, Z. Etugert Llazi, i cili bëri një prezantim të përgjithshëm të Nomenklaturës së klasifikimit të llojeve të ndërtimit (KN). Z. Llazi shpjegoi qëllimin, strukturën, parimet dhe përkufizimet e këtij klasifikimi. Ky klasifikim, shërben për hartimin dhe grumbullimin e treguesve të lejeve të ndërtimit sipas seksioneve

dhe divizioneve që ky klasifikim përmban. Gjithashtu kjo nomenklaturë shërben dhe për klasifikimin dhe kodifikimin e treguesve të lejeve të ndërtimit.

3. Diskutime të tjera

Znj. Dhuli sqaroi procedurën e Miratimit të Klasifikimit GEONOM. Ky klasifikim pasi të kalojë procedurën e përkthimit do ju paraqitet paraprakisht anëtarëve për komente e më pas do të kalojë për miratim në KM, për të vazhduar më tej me fazën e zbatimit.

Znj. Dhuli u ndal dhe një herë në dy klasifikimet PRODCOM dhe CPA të cilat janë kërkuar të përkthehen nga Ministria për Evropën dhe Ministra e Jashtme.

Nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është kërkuar përkthimi i Nomenklaturës së Ndarjeve Rajonale për vitin 2016. Shqipëria dhe INSTAT zbaton Nomenklaturën e Ndarjeve Rajonale 2013. Klasifikimi i vitit 2016 në parim nuk ka ndryshime në nomenklaturë, por shtete të ndryshme kanë ndryshime në përbërjen e tyre në nivele më të detajuara. Pra INSTAT nuk e konsideron pjesë për tu përkthyer.

Znj. Ibrahimaj kërkoi mendim nga Znj. Dikensa Gjokutaj, përfaqësuese e Ministrisë së Arsimit , Sporteve dhe Rinisë, për ecurinë e procesit të ISCED, duke theksuar që përkthimi dhe rishikimi nga të gjithë anëtarët e KKN është realizuar. Ministria e Arsimit si institucioni i lidhur drejtpërdrejtë me ISCED , duhet ta rishikojë dhe të shprehë komentet. Znj. Gjokutaj u shpreh se shkak për këtë vonesë është ristrukturimi i institucioneve në varësi të Ministrisë. Në 6-mujorin e dytë mund të filloj puna për rishikimin e këtij klasifikimi.

Në fund të takimit Znj. Sala, anëtare e KKN, theksoi që klasifikimet të cilat dërgohen për rishikim tek anëtarët e KKN, të qarkullojnë në departamentet e institucioneve të tyre. Kjo do të sjellë gjithëpërfshirjen e aktorëve në procesin e rishikimit të klasifikimeve dhe shmangien e vonesave gjatë procesit të miratimit nga KM.

Përgatiti:

Sekretariati i KKN